

## Pyetje dhe Përgjigje

*Tender Nr. 18 – “Shërbimi i sigurisë fizike për nënzonat e trashëgimisë dhe peizazhit kulturor, pjesë e Parkut Kombëtar të Butrintit”*

**(Pyetje)** - Në lidhje me pikën nr. 12 *“Autorizim i lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për përdorimin e mjeteve speciale për vitin 2025 në vijim”* është kthyer përgjigje lidhur me kategorinë **1.3.B “Shërbimi i sigurimit dhe shoqërimit të vlerave monetare gjatë transportit”**

**(Përgjigje)** – Ju bëjmë me dije se autorizimi i pikes nr. 12 duhet dorëzohet sikurse përcaktohet në Kërkesën për Tender për përdorimin e mjeteve speciale. Lidhur me kategorinë 1.3.B për *“Shërbimi i sigurimit dhe shoqërimit të vlerave monetare gjatë transportit”* **nuk kërkohet në këtë tender.**

**(Pyetje)** - Sqarim për rradhitjen e numrave rendore të dokumentacionit pas pikes 15, faqja nr. 4 e dokumentit “Kërkesë për Blerje”, ku në faqen Nr. 5 është 23.

**(Përgjigje)** – Pasaktësi e korrigjuar dhe reflektuar në njoftimin përkatës të publikimit për “Saktësim në pikën 1.14.” Lista e dokumentacionit që do të dorëzohet”, për numrat rendorë të dokumentacionit faqe nr. 5, pikat 23, 24 dhe 25 bëhen 16, 17 dhe 18 me të njëjtën përmbajtje”.

**(Pyetje)** - Sqarim për pikën 2.3 “Informacion Shtesë” nënpika nr. 5, *“Nënkontraktimi nëse është i nevojshëm, lejohet vetëm për krijimin e sallës së monitorimit dhe mirëmbajtjen e sistemit CCTV”* për këtë pike **kërkojmë më shumë detaje teknike** në lidhje me ofrimin e shërbimit.

**(Përgjigje)** - Lidhur me detajet që kërkohen sugjerojmë ti referoheni pikës 4.2 të Termave të Referencës. Për sqarime të mëtejshme **lutemi specifikoni pyetjet apo paqartësitë që keni.**

**(Pyetje)** - Në faqen e internetit si afat i fundit për dorëzimin e zarfave është përcaktuar data **17.09.2025 ora 11.00**, ndërsa tek dokumentacioni i tenderit, "Kërkesat për Tender" (KPT)" pika 1.6, është përcaktuar datë **17.09.2025 ora 12.00**. Të përcaktohet nëse është ora 11.00 apo ora 12.00, afati i fundit për dorëzimin e ofertes.

**(Përgjigje)** - Lidhur me saktësimin e **orarit të dorëzimit** bëjmë me dije se **është ora 11:00, date 17.09.2025.**